



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT

PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTVENDIMIT

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 872, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ENERGJINË DHE KLIMËN 2020 – 2030”

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 872, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020 – 2030””.

Shqipëria është angazhuar për përgatitjen e PKEK-së së saj të parë gjatë vitit 2020, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 872, datë 29.12.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2020 – 2030”. PKEK-ja plotëson Strategjinë e Energjisë, e cila krijon një kuadër politik të integruar për udhëheqjen e përpjekjeve të dekarbonizimit deri në vitin 2030 e më tej, në përputhje me qëllimet e Paktit të Gjellbër Evropian.

Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) iu është nënshtruar rishikimeve të mëtejshme për t’u harmonizuar me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (EnCS) për përmirësimin e PKEK-së, dhe për t’iu përshtatur objektivave të reja për vitin 2030.

Procesi i rishikimit të PKEK-së për të adresuar rekomandimet e EnCS-së filloi në vitin 2022 dhe plani ka pësuar rishikime të mëtejshme gjatë vitit 2024, me mbështetje nga asistenca teknike e GIZ-it, për t’u përafruar me objektivat e reja për vitin 2030 të përcaktuara nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë. Kjo bazohet në Vendimin Nr.2022/02/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të

Energjisë, datë 15 dhjetor 2022, lidhur me reduktimin e gazrave serrë (GHG), përqindjen e burimeve të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, përkatësisht për konsumin final të energjisë dhe konsumin primar të energjisë.

Ky plan bazohet në këto dokumente të rëndësishme:

1. Strategjia Kombëtare e Energjisë për periudhën 2018–2030 (VKM nr. 480, datë 31.7.2018), si dokumenti kryesor strategjik për sektorin e energjisë në vend,
2. Dokumenti i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar, NDC-të (VKM nr. 581, datë 6.10.2021), për objektivat kombëtare për klimën, si dhe 3 Marrëveshjet evropiane (siç është Pakti i Parisit dhe Deklarata e Sofjes mbi Paktin e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, si pjesë e “Procesit të Berlinit” në nëntor të vitit 2020).

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektvendim është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel ekspertit dhe qytetari) në datë 20 Dhjetor 2024 deri në 14 Shkurt 2025, për një periudhë prej 40 ditë pune.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektligji “Për miratimin e strategjisë afatgjatë të rinovimit të stokut të ndërtesave”, u konsultua:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 20 Dhjetor 2024 deri në 14 Shkurt 2025;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 20 Dhjetor 2024 deri në 14 Shkurt 2025;

3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Në hartimin e këtij projektakti u përfshinë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Palët e interesuar që kanë kontribuar me komente dhe rekomandime ishin:

- Lëvizja për Energjinë dhe Klimë;
- Shoqata e Bujqësisë Organike (SHBO);
- Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA);
- Rrjeti CEE Bankëatch, Prague, Republika Çeke.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektvendimi Për disa ndryshime në vendimin nr. 872, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020 – 2030”, ka pasur 745 lexime nga qytetarët, 399 lexime nga ekspertët dhe disa reagime nëpërmjet adresës elektronike të koordinatorit të konsultimit publik, nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, gjithashtu nga 4 organizata të shoqërisë civile:

Në tabelën si më poshtë gjenden të reflektura komentet e bëra nga aktorët e interesuar:

Nr.	Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuar a	Vendimi	Justifikimi
1	Roli i termocentraleve dhe TEC-it lundruar	Komentet adresojnë domosdoshmërinë e përfshirjes së termocentraleve në PKEK si kapacitete tranzitore për sigurinë energjetike.	Lëvizja për Energjinë dhe Klimën; PPNEA; CEE Bankëatch ; Shoqata e Bujqësisë Organike	Pranuar pjesërisht –	Kapitulli 3.3 (Siguria energjetike) dhe tabelat 30, 60 etj. flasin për TEC-in si pjesë e projeksioneve dhe kapacitet tranzitor. Plani i përmend si kapacitete tranzitore, por mungon analiza e detajuar e emetimeve dhe lidhja me ETS/CBAM , me të cilën do të procedohet pas miratimit të bazës ligjore për keto të fundit.

2	Burimet e rinovueshme dhe objektivat e BRE	Është theksuar objektivi ligjor për 54.4% pjesëmarrje të BRE deri në vitin 2030 dhe projeksionet e draft PKEK se rishikuar për tejkalimin deri në 59.4%. Komentet fokusohen tek diversifikimi I energjise permes fotovoltaikeve, erës, biomasës dhe biokarburanteve, si dhe sfidat e rrjetit për integrimin e tyre.	OSFA; Lëvizja për Energjinë dhe Klimën	Pranuar pjesërisht	– Kapitujt 2.1.2, 3.1.3 dhe tabelat 35–37, 54–55 japin objektivat dhe skenarët deri në 2030/2050. Plani vendos objektivin dhe skenarët, por nuk merr ne konsiderate kufizimet e rrjetit.
3	Komunitetet e energjisë dhe vetëprodhimi	Theksohet vonesa në krijimin e komuniteteve të energjisë për shkak të mungesës së akteve zbatuese dhe kuadrit ligjor. Është theksuar roli i tyre për tranzicionin e decentralizuar dhe përfshirjen e qytetarëve në tregun e energjisë.	OSFA; Lëvizja për Energjinë dhe Klimën	Pranuar pjesërisht –	Në kapitujt për tregun e brendshëm (2.4, 3.4) dhe në seksionet mbi konsumatorët, por jo shumë i detajuar mbi statusin e krijimit të komuniteteve. Përmendet masa R-E9, por financimi është minimal dhe ligji ende pa akte

					nënligjore ne kete faze.
4	Gazifikimi dhe infrastruktura e gazit	Gazifikimi shihet si masë tranzitore për diversifikimin e furnizimit dhe sigurinë energjetike. Organizatrat shprehen për rrezikun e varësisë nga lëndët djegëse fosile dhe nevojën për përshtatje me objektivat e neutralitetit klimatik.	PPNEA; CEE Bankëatch ; Shoqata e Bujqësisë Organike	Pranuar —	Kapitulli 2.4.2, 3.3.3 (Sektori i gazit) dhe projeksionet për gazsjellësit.
5	HEC-i i Skavicës dhe hidrocentralet	Komentet adresojnë ndikimet mjedisore dhe sociale të ndërtimit të Skavicës, duke kërkuar VNM të plotë dhe konsultim me komunitetet. Përmendet gjithashtu fleksibiliteti që ofron sistemi hidroenergjetik në krahasim me burimet e tjera.	PPNEA; CEE Bankëatch	Pranuar —	Përmenden në seksionet për hidroenergji në dhe projekte madhore, si pjesë e fleksibilitetit të sistemit.
6	Industria e çimentos dhe përdorimi i hidrogjenit	Plani parashikon masa për industrinë e çimentos (përdorimi i	PPNEA; Shoqata e Bujqësisë Organike	Pranuar —	Kapitulli 3.1.2 (industria) dhe 3.1.3 (hidrogjeni

		karburanteve alternativë dhe teknologji të reja), si dhe rolin e hidrogjenit të gjelbër për sektorët e vështirë për t'u dekarbonizuar.			për sektorët e vështirë).
7	Menaxhimi i mbetjeve dhe inceneratorët	Ka shqetësime për rolin e djegies së mbetjeve dhe ndikimet mjedisore të saj. Sugjerohet që parandalimi, riciklimi dhe kompostimi të kenë përparësi sipas hierarkisë së BE-së. Përmenden edhe masat për mbetjet urbane dhe ato industriale.	PPNEA; CEE Bankëatch	Pranuar –	Kapitulli 3.1.2 (sektori i mbetjeve) dhe 4.1.2 (mbetjet). Përmendet hierarkia e BE-së.
8	Sektori i pyjeve (LULUCF)	Është vënë në dukje pesha e madhe që i është dhënë pyjeve për thithjen e karbonit. Komentet kërkojnë që kjo të mos zëvendësojë masat në sektorët e tjerë, por të kombinohet me menaxhim të qëndrueshëm pyjor, ripyllëzim dhe agropylltari.	PPNEA; Shoqata e Bujqësisë Organike; CEE Bankëatch	Pranuar –	Kapitulli 3.1.2 (Ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet) dhe 4.1.2/4.2.1 (LULUCF).
9	Varfëria energjetike	Është ngritur çështja e përkufizimit dhe	OSFA	Pranuar –	Kapitulli 2.4.3 dhe 3.4.3 flasin

		masave për trajtimin e varfërisë energjetike, si dhe ndjekjes së grupeve vulnerabël në përputhje me direktivat e BE-së.			për varfërinë energjetike dhe masat për grupet vulnerabël.
10	Projeksionet makroekonomike dhe demografike	Komentohet përdorimi i supozimeve të vjetra për PBB dhe popullsinë, mungesa e burimeve të qarta për projeksionet dhe nevoja për transparencë të shtuar.	OSFA	Pranuar –.	Kapitulli 4.1.1 (parashikimet në nivel makroekonomik, PBB dhe popullsia) dhe figura 19–20